

Vendim nr. 278 datë 18.11.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj, Kryetare
Genti Ibrahim, Anëtar
Sonila Bejtja, Anëtare

në datën 18.11.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 41 (A) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: ADRIATIK SALLAHU

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-1221, datë 28.03.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 15, 42, pika 2, 44, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6, pika 1, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 27, 50, pika 4, 71, pika 1 dhe 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Shtetasi Adriatik Sallahu (*kërkuesi*) ka paraqitur në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë kërkesëpadinë me objekt konstatimin e pavlefshmërisë së procesverbalit nr. 7587350, të datës 06.05.2018, të Komisarariatit Rajonal të Policisë Rrugore Tiranë, me objekt konstatim shkeljeje dhe detyrimin e palës së paditur ta dëmshpërblejë atë për dëmin material dhe jomaterial nga veprimet e paligjshme. Palë të paditura në këtë proces janë Drejtoria Vendore e Policisë Rrugore Tiranë dhe Komisaritati Rajonal i Policisë Rrugore Tiranë.

2. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 2752, datë 13.07.2018, ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë, duke konstatuar pavlefshmërinë e procesverbalit të mësipërm, të nxjerrë nga organi administrativ në Drejtorinë Vendore të Policisë Rrugore Tiranë. Për kërkimin e dytë të kërkuesit që lidhet me dëmshpërblimin, kjo gjykatë ka vendosur rrëzimin e tij. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim pala e paditur dhe çështja është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit në datën 13.09.2018 me nr. akti 14983 (31159-03547-86-2018).

3. Në datën 10.02.2024 kërkuesi ka paraqitur në Gjykatën Administrative të Apelit kërkesën për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm në gjykimin e çështjes administrative dhe përshpejtimin e procedurave për gjykimin e saj, kërkesë e cila është regjistruar në atë gjykatë në datën 12.02.2024. Gjykata Administrative e Apelit e ka përcjellë kërkesën e mësipërme në Gjykatën e Lartë, ku ajo është regjistruar në datën 21.02.2024. Kërkuesi ka parashtruar, ndër të tjera, në kërkesë se nga momenti i regjistrimit të ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit e deri në datën e depozitimit të kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm kanë kaluar 5 vjet dhe ende nuk është planifikuar data për gjykimin e çështjes. Në këto rrethana, sipas kërkuesit, procedurat janë tejzgatur dhe është kaluar çdo afat i arsyeshëm për shqyrtimin e ankimit të tij.

4. Me anë të shkresës nr. 659/1 prot., datë 19.02.2024, gjyqtari relator në Gjykatën Administrative të Apelit ka paraqitur mendimin e tij përpara Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë lidhur me kërkesën e kërkuesit për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm. Ai ka parashtruar se për shkak të rishortimit të mëparshëm të saj, çështja i ka kaluar në ngarkim përmes shortit të datës 15.11.2023. Sipas gjyqtarit relator, për gjykimin e çështjeve Gjykata Administrative e Apelit procedon me detyrimin për respektimin e radhës së tyre kronologjike. Ndërkohë kjo gjykatë ka funksionuar me numër të reduktuar gjyqtarësh, ndaj aktualisht gjyqtari relator ka në gjykim çështje që i përkasin vitit 2017. Po sipas tij, për shkak të ngarkesës së madhe të punës, si dhe nisur nga fakti se gjykata e apelit ka juridiksion fillestar për një kategori çështjesh, ka qenë i

pamundur shqyrtimi në kohë i kërkesave për përsheptim të gjykimit. Pavarësisht kësaj, gjyqtari relator është shprehur se çështja e kërkesit do të shqyrtohet në një kohë sa më të afërt të mundshme brenda gjashtëmujorit të parë të vitit 2024.

5. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-1221, datë 28.03.2024, ka vendosur pushimin e gjykimit të kërkesës së kërkesit, me arsyetimin se nga ana e Gjykatës Administrative të Apelit është deklaruar se janë marrë masa për planifikimin e gjykimit të çështjes së themelit dhe afati është i arsyeshëm, ndaj kërkesa e kërkesit ka mbetur pa objekt.

6. Në datën 02.09.2024 kërkesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 01.10.2024.

II

Pretendimet e kërkesit

7. **Kërkesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, në drejtim të:

7.1. *Së drejtës për një gjykim të drejtë brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e paanshme*, pasi çështja objekt gjykimi është regjistruar në datën 13.09.2018 në Gjykatën Administrative të Apelit dhe ndonëse kanë kaluar 6 vjet ende nuk është caktuar data për gjykimin e saj, në kundërshtim me nenin 399/2/1/a të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*). Në këtë mënyrë ajo gjykatë ka tejkaluar afatin e arsyeshëm të gjykimit nga momenti i regjistrimit të ankimit. Edhe Gjykata e Lartë ka pushuar gjykimin e kërkesës për konstatim të cenimit të afatit të arsyeshëm dhe për përsheptimin e çështjes haptazi në mënyrë arbitrare, ndërkohë që kishte detyrimin ligjor të konstatonte vonesën në gjykimin e çështjes së themelit nga gjykata e apelit. Arsyetimi i Gjykatës së Lartë, sipas së cilit çështja pushohet pasi gjyqtari relator i gjykatës së apelit ka deklaruar se do ta gjykojë çështjen brenda 6-mujorit të parë të vitit 2024, është i papranueshëm dhe bie në kundërshtim me dispozitat procedurale. Vendimi i asaj gjykate përbën pengesë për vijueshmërinë e gjykimit të çështjes së themelit në gjykatën e apelit. Pushimi i gjykimit të kërkesës është bërë pa bazë procedurale, por në bazë të aludimeve, pasi gjykata e apelit edhe pse ka kaluar 6-mujori i parë i vitit 2024, ende nuk ka caktuar një datë për gjykimin e çështjes.

7.2.Së drejtës për t'u zhdëmtuar në përputhje me ligjin, të garantuar nga neni 44 i Kushtetutës, pasi Gjykata e Lartë ka dhënë një vendim të padrejtë, duke i mohuar të drejtën për të kërkuar shpërblim të drejtë në bazë të dispozitave të KPC-së.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuarit

8. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e ankimit kushtetues individual janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Për pasojë, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuari të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyimit kushtetues.

9. Kolegji vlerëson se kërkuari, si bartës i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi është palë ndërgjyqëse në procesin gjyqësor për të cilin ka ngritur pretendime në drejtim të standardit të gjyimit brenda një afati të arsyeshëm.

10. Një kriter tjetër është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, i parashikuar nga neni 131, pika 1, shkronja “F”, i Kushtetutës dhe neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000, që kërkon shfrytëzimin në rrugë normale të mjeteve juridike efektive, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete. Për sa u përket kërkesave për konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, Gjykata ka mbajtur qëndrimin se legjislacioni i brendshëm tashmë parashikon mjete juridike efektive që i ofrojnë individit rezultate konkrete për rivendosjen e kësaj të drejte kushtetuese. Në këtë kuptim, individit duhet t'u drejtohet gjykatave të zakonshme, në përputhje me parashikimet e neneve 399/2 e vijues të KPC-së, dhe

vetëm pasi të ketë shteruar garancitë e mbrojtjes që i ofrohen nga juridiksioni i zakonshëm gjyqësor, ai mund të vërë në lëvizje gjykimin kushtetues (*shih vendimet nr. 46, datë 03.10.2023; nr. 44, datë 26.09.2023; nr. 2, datë 17.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Kolegji vëren se kërkuesi, në kushtet e mungesës së një vendimmarrjeje të Gjykatës Administrative të Apelit për çështjen e tij, i është drejtuar asaj me kërkesën e datës 12.02.2024 për konstatimin e cenimit të afatit të arsyeshem dhe përshpejtimin e gjyimit. Kjo kërkesë është përcjellë në Gjykatën e Lartë, ku edhe është regjistruar në datën 21.02.2024. Me vendimin nr. 00-2024-1221, datë 28.03.2024, Gjykata e Lartë ka vendosur pushimin e gjyimit të kërkesës, ndaj i vetmi mjet në dispozicion të kërkuesit për rivendosjen e së drejtës së pretenduar të cenuar është ankimi kushtetues individual. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se kërkuesi e ka përmbushur kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive, të parashikuar nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës dhe neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000.

12. Për sa i takon legjitimitet *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4-muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Në rastin kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, Gjykata e ka llogaritur afatin ligjor 4-mujor duke filluar nga data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshem për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose njoftimit elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimet nr. 42, datë 19.09.2023; nr. 40, datë 14.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Në rastin në shqyrtim Kolegji vëren se vendimi i Gjykatës së Lartë, që mban datën 28.03.2024, është publikuar në faqen zyrtare të saj në datën 26.04.2024, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 02.09.2024. Në kushtet kur çështja e themelit vazhdon ende të jetë në shqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit dhe për të nuk rezulton të jetë caktuar data e seancës, si duke pasur parasysh edhe natyrën e kërkimit në ankimin kushtetues individual, Kolegji vlerëson se kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

14. Në drejtim të legjitimitet *ratione materiae*, Kolegji vëren se në thelb objekt i ankimit kushtetues individual është tejzgjatja e procedurave gjyqësore për shqyrtimin e çështjes së kërkuesit në Gjykatën Administrative të Apelit, e cila *prima facie* përfshihet në juridiksionin kushtetues, ndaj do të analizohet në vijim.

B.1. Për cenimin e parimit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm

15. Kërkuesi ka pretenduar se çështja objekt gjykimi është regjistruar në datën 13.09.2018 në Gjykatën Administrative të Apelit dhe ndonëse kanë kaluar 6 vjet ende nuk është caktuar data për gjykimin e saj, në kundërshtim me nenin 399/2/1/a të KPC-së. Në këtë mënyrë ajo gjykatë ka tejkaluar afatin e arsyeshëm të gjykimit nga momenti i regjistrimit të ankimit. Po sipas kërkuesit, edhe Gjykata e Lartë ka pushuar gjykimin e kërkesës për konstatimin e cenimit të afatit të arsyeshëm dhe për përshpejtimin e çështjes haptazi në mënyrë arbitrare, ndërkohë që kishte detyrimin ligjor të konstatonte vonesën në gjykimin e çështjes së themelit nga Gjykata Administrative e Apelit. Arsyetimi i Gjykatës së Lartë, sipas së cilit çështja pushohet pasi gjyqtari relator i Gjykatës Administrative të Apelit ka deklaruar se do ta gjykojë çështjen brenda 6-mujorit të parë të vitit 2024, është i papranueshëm dhe bie në kundërshtim me dispozitat procedurale. Vendimi i asaj gjykate përbën pengesë për vijueshmërinë e gjykimit të çështjes së themelit në gjykatën e apelit. Pushimi i gjykimit të kërkesës është bërë pa bazë procedurale, por në bazë të aludimeve, pasi gjykata e apelit edhe pse ka kaluar 6-mujori i parë i vitit 2024, ende nuk ka caktuar një datë për gjykimin e çështjes.

16. Neni 42 i Kushtetutës përcakton se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka vlerësuar se kohëzgjatja e gjykimit, normalisht, llogaritet nga momenti i fillimit të procesit gjyqësor deri në dhënien e vendimit dhe se në kohëzgjatjen e përgjithshme të gjykimit nuk përjashtohen vonesat e shkaktuara nga zbatimi i reformës në drejtësi, pasi barra e këtyre vonesave nuk duhet të zhvendoset te palët ndërgjyqëse (*shih vendimet nr. 43, datë 04.06.2024; nr. 37, datë 07.05.2024; nr. 21, datë 04.04.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Në rastin konkret, Kolegji vëren se kërkuesi ka paraqitur në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë kërkesëpadi me objekt konstatimin e pavlefshmërisë së procesverbalit nr. 7587350 të datës 06.05.2018 dhe detyrimin e palës së paditur, Drejtorisë Vendore të Policisë Rrugore Tiranë, ta dëmshpërblejë atë për dëmin material dhe jomaterial nga veprimet e paligjshme. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë duke konstatuar pavlefshmërinë e procesverbalit të nxjerrë nga organi administrativ në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë, ndërsa për kërkimin e dytë që lidhet me dëmshpërblimin, kjo gjykatë ka vendosur rrëzimin e tij. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim pala e paditur në gjykatën e apelit në datën 13.09.2018. Si rezultat nga momenti i regjistrimit të çështjes në Gjykatën

Administrative të Apelit (13.09.2018) deri në shqyrtim e saj në Gjykatë kanë kaluar më shumë se 6 vjet dhe ende nuk ka një vendimmarrje për të.

18. Lidhur me afatet e gjykimit të mosmarrëveshjes administrative, KPC-ja, me ndryshimet e vitit 2017, në grupin e rregullave për mjetet e ankimit për konstatimin e shkeljeve të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm, ka përcaktuar afatin 1-vjeçar për përfundimin e gjykimit në shkallë të dytë (neni 399/2, pika 1, shkronja “a”, i KPC-së). Kjo nënkupton se formalisht gjykimi i çështjes në Gjykatën Administrative të Apelit ka tejkaluar afatin e përcaktuar ligjor. Sipas verifikimeve të kryera në faqen zyrtare të Gjykatës Administrative të Apelit rezulton se ende nuk është caktuar një datë për shqyrtimin e çështjes së kërkuarit.

19. Në vështrim të standardeve të mësipërme, për të vlerësuar nëse në rastin në shqyrtim ka pasur tejzgjatje të paarsyeshme të afatit, pra nëse kërkuarit i është cenuar e drejta kushtetuese për proces të rregullt në këtë aspekt, do të analizohen rrethanat e veçanta të çështjes konkrete dhe kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese që lidhen me: (i) sjelljen e kërkuarit; (ii) kompleksitetin e çështjes; (iii) sjelljen e autoriteteve; (iv) rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuarit (shih vendimet nr. 68, datë 07.12.2023; nr. 6, datë 16.02.2023; nr. 13, datë 26.05.2022 të Gjykatës Kushtetuese).

20. Në lidhje me sjelljen e kërkuarit Kolegji vëren se kërkuarit, pasi ka konstatuar se nuk ishte planifikuar shqyrtimi i ankimit të tij në Gjykatën Administrative të Apelit, në përputhje me parashikimet e KPC-së, në datën 10.02.2024 ka paraqitur në atë gjykatë kërkesë për konstatimin e cenimit të afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes, e cila është regjistruar në datën 12.02.2024. Në vijim kërkesa i është përcjellë Gjykatës së Lartë, ku është regjistruar në datën 21.02.2024. Më tej, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur pushimin e gjykimit të kërkesës së kërkuarit.

21. Në rastin konkret, Kolegji çmon se kërkuarit ka vepruar në përputhje me të drejtat e tij procedurale dhe nuk rezulton të jetë bërë shkak ose të ketë shkaktuar vonesa për gjykimin e çështjes.

22. Për sa i takon kompleksitetit të çështjes, Kolegji vëren se mosmarrëveshja objekt gjykimi është e natyrës administrative, që rregullohet nga ligji nr. 49/2012. Si palë në gjykimin në shkallë të parë krahas kërkuarit kanë qenë Drejtoria Vendore e Policisë Rrugore Tiranë dhe Komisariati Rajonal i Policisë Rrugore Tiranë. Në objektin e kërkesëpadsisë së kërkuarit kërkohet konstatimi i pavlefshmërisë së procesverbalit nr. 7587350, datë 06.05.2018 dhe detyrimi i palës së paditur ta dëmshpërblejë atë për dëmin material dhe jomaterial nga veprimet e paligjshme. Në këtë

çështje Gjykata Administrative e Shkallës së Parë ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë së kërkuarit, ndërkohë që pala e paditur nëpërmjet ankimit ka vënë në lëvizje Gjykatën Administrative të Apelit. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se çështja nuk paraqitet komplekse për të justifikuar kohëzgjatjen e shqyrtimit.

23. Për sa i përket *sjelljes së autoriteteve*, Kolegji vëren se çështja e kërkuarit është në pritje për shqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit tashmë prej më shumë se 6 vjetësh. Në bazë të verifikimeve të kryera në faqen zyrtare të asaj gjykate rezulton se gjyqtari relator i çështjes nuk ka caktuar ende datën e seancës gjyqësore. Bazuar në informacionin dhe argumentet e parashtruara nga gjyqtari relator në Gjykatën Administrative të Apelit përpara Gjykatës së Lartë rezulton se vonesa në gjykimin e çështjes ka ardhur si pasojë e ngarkesës së lartë të çështjeve në shqyrtim dhe numrit të kufizuar të gjyqtarëve efektivë në këtë gjykatë. Prandaj, në analizë të të dhënave të mësipërme, Kolegji vlerëson se kohëzgjatja e gjykimin të çështjes së kërkuarit lidhet me ngarkesën e lartë të punës në gjykatën e apelit, shkaktuar nga zbatimi i reformës në drejtësi.

24. Së fundmi, në lidhje me *rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuari*, Gjykata ka vlerësuar se disa kategori çështjesh, për shkak të natyrës së tyre, kërkojnë përshejtim të posaçëm të gjykimin, nisur nga interesi veçanërisht i lartë i kërkuarit. Disa çështje që lidhen me interesa “vetjakë e jetësorë” nevojitet të trajtohen me shpejtësi e përparësi. Të tilla janë çështjet që kërkojnë “kujdes të veçantë” ose “kujdes të jashtëzakonshëm”, si ato që lidhen me statusin civil, kujdestarinë e fëmijëve, marrëdhëniet e punësimit, sëmundjet e pashërueshme dhe pensionin. Lista e këtyre çështjeve nuk mund të jetë shteruese dhe kriteri i interesit të kërkuarit në proces verifikohet nga Gjykata rast pas rasti (*shih vendimet nr. 43, datë 04.06.2024; nr. 21, datë 04.04.2024, nr. 6, datë 16.02.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Bazuar në argumentet e paraqitura në kërkesë Kolegji vëren se ato nuk përbëjnë shkak të mjaftueshëm për të provuar se çështja e kërkuarit është e një natyre të tillë që interesat “vetjakë e jetësorë” të kërkuarit të rrezikohen në shkallë të konsiderueshme nga kohëzgjatja e procedurave gjyqësore në Gjykatën Administrative të Apelit. Në këto kushte, në lidhje me rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuari për shkak të vonesës së Gjykatës Administrative të Apelit në shqyrtimin e çështjes së tij, Kolegji çmon se, në kontekst të rrethanave të rastit, ai nuk ka argumentuar dhe provuar rrezikun për interesat e tij, natyra dhe rëndësia e të cilëve të justifikojë trajtimin me përparësi dhe shpejtësi të veçantë të çështjes së tij.

26. Si rrjedhim, duke vlerësuar së bashku përfundimet e analizës të secilës prej kritereve të mësipërme që janë përcaktuese të kohëzgjatjes së arsyeshme të procesit, në kuptim të rëndësisë së

asaj çfarë rrezikon kërkuesi, Kolegji çmon se çështja e tij nuk përbën shkak të arsyeshëm në aspektin kushtetues për t'u shqyrtuar me prioritet, prandaj pretendimi i tij për cenimin e parimit të gjyqimit brenda një afati të arsyeshëm është haptazi i pabazuar.

27. Në përfundim, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.